



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2966 / prot.  
16

Tiranë, më 15/11 /2022

Lënda: Informacion mbi Raportin e Auditimit 2022

**Znj. Lindita NIKOLLA**  
**KRYETARES SË KUVENDIT**

**BYROSE SE KUVENDIT**

*E nderuar zonja Kryetare,*

*Të nderuar deputetë,*

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Kuvendin e Shqipërisë, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 350/2, datë 16.05.2022 “Mbi Auditimin e përputhshmërisë” datë 14.12.2016, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në fushën e hartimit dhe zbatimit të buxhetit, mbajtjen e evidencave kontabël dhe respektimin e kriterëve për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, rregullshmërinë e procedurave të prokurimeve me fondet publike dhe zbatimin e kontratave, aspektet e menaxhimit financiar, kontrollit dhe qeverisjes, etj.

Auditimi u krye me zgjedhje, dhe në mënyre të njëpasnjëshme dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2017-30.04.2022, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit si dhe janë audituar me zgjedhje dosjet sipas programit për periudhën objekt auditimi.

Në datën 06.10.2022 , KLSH, përcolli raportin përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet .

*A. Opinioni i Auditimit*

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të Kuvendit të Shqipërisë, në të gjitha aspektet është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Oponioni të Pakualifikuar”<sup>1</sup>*

*B. Janë propozuar përmirësime në legjislacionin dhe aktete nënligjore në fuqi.*

Nga auditimi u konstatua se është e nevojshme rishikimi dhe përmirësimi i kornizës ligjore dhe akteve nënligjore mbi statusin dhe trajtimin financiar të deputetëve të Kuvendit, duke u mbështetur në praktikat dhe modelet më të mira të vendeve Evropiane. Sipas grupit të audituesve të KLSH mungon harmonizimi mes ligjit nr.8550, date 18.11.1999 “Statusi për deputetit” i ndryshuar dhe

<sup>1</sup> Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të klsh-se (qershor 2020, faqe 104, “oponioni të pakualifikuar” është kur nuk janë gjetur apo konstatuar rast të mospërputhjes materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”

Vendimit 114 të Kuvendit, me parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi (ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5 Ministrisë së Financave etj.

**Rekomandimi:** Të merren masat për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi statusin me trajtimin financiar dhe kompesimin e shpenzimeve për deputetët e Kuvendit, duke u mbështetur në praktikët më të mira. Për këtë , të gjënden përcaktimi në ligjin nr.8550 “Statusi i deputetit” i ndryshuar, ose të bëhen përmirësimet e nevojshme në Vendimin 114 të Kuvendit duke u shprehur në mënyrë përfundimtare në kuadër të trajtimit financiar të deputetit lidhur me faktin nëse:

a.deputetët e Kuvendit duhet të përfitojnë pagën dhe përfitimet financiare për rastet e bojkotimit të punimeve të Kuvendit pas fitimit të mandatit, si pasojë e vendimmarrjes politike të një partie apo e një grupi parlamentar, dhe

b.deputetët e Kuvendit, duhet të përfitojnë trajtim financiar, në lidhje me kategoritë të tilla si dieta, karburant etj në periudhën ndërmjet sesioneve parlamentare, apo gjatë periudhës së fushatave zgjedhore.

2. Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit, e miratuar me vendimin nr.42, datë 16.07.2015, i ndryshuar , të Byrosë së Kuvendit, në disa nene të saj nuk është e harmonizuar me kuadrin ligjor të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik. Për rrjedhojë, ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 10, “Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Njësia e Auditimit në strukturë nuk përgjigjet dhe raporton përpara Titullarit të Njesisë Publike, ose Byrosë së Kuvendit, por tek Nëpunësi Autorizues i Institucionit.

**Rekomandimi :** Të rishikohet dhe përmirësohet Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimit të Kuvendit, miratuar me Vendimin nr.42 datë 16.07.2015 të Byrosë së Kuvendit përkatësisht në nenin 12/3, 14/1, 16.

*C. Masa Organizative- Raporti Përfundimtar trajton dhe 7 gjetje.*

Shërbimet e institucionit të Kuvendit me marrjen e Raportit Përfundimtar të auditimit plotësoi dhe dërgoi pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit “Planin e Veprimit në zbatim të Rekomandimeve të Auditimit të KLSH” me shkresën 2966/5 prot datë 28.10.2022. Po vijohet puna me prioritet në marrjen e masave sipas problematikave dhe rekomandimeve të paraqitura në këtë raport auditimi, duke bërë me dije Byronë e Kuvendit dhe KLSH për masat e marra.

Duke Ju falenderuar për vëmendjen, bashkëlidhur do të gjeni Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin të KLSH si dhe Planin e Masave të marra nga Kuvendi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2866/Prot.  
14

Tiranë, më 28, 10, 2022

Miratohet  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
GENCI GJONCALI

PLANI VEPRIMI NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT TË KLSH

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Auditimi i KLSH, të përcjella me nr.350/8 datyë 06.10.2022, Shërbimet e Kuvendit duhet të plotësojnë masat (aktivitetet) si më poshtë listohen, duke i qëndruar rigoroz afateve dhe përgjegjësi:

Nr.	Refer ne Raportin KLSH	Rekomandimet	Strukturat Personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve	Personat përgjegjës ndjekjen e realizimit te rekomandimeve	Afati i përcaktuar
<b>B.PROPOZIME PER NDRYSHIME APO PERMIRESIME NE LEGJISLACION DHE AKTE NENLIGJORE NE FUQI</b>					
1	1.1	Të rishikohet kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi për statusin e deputetit dhe vendimi për trajtimin e deputetëve duke u mbështetur në praktikat më të mira europiane dhe duke reflektuar ndryshimet e mjedisit të kontrollit të brendshëm në vend si dhe plotësimin e vakuumit në lidhje me raser e bojkoti, periudhën e pushimeve dhe periudhës ndërmjet sesioneve, periudhën zgjedhore etj.	Grupi i punës me Urdhrin nr. 320 datë 21.09.2022	Sekretari i Përgjithshëm; Sekretarati Buxheti, Byroja e Kuvendit	Brenda muajit Nëntor 2022
2	2.1	Rishikimi i Rregullores së Oganizimit dhe Funksionimit të Shërbimeve në Kuvend, i miratuar me vendimin nr.42 të Byrosë, datë 16.07.2015, duke marrë parasysh gjejeje dhe rekomandimet e auditimit të KLSH	Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputeteve; grup pune	Sekretari i Përgjithshëm Byroja e Kuvendit	Gjate vitit 2023

**C MASA ORGANIZATIVE**

3	1.1	Shërbimi Administrativ, të marrë masa për sigurimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe realizimin e procesit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme (ndërtesa dhe troje) me vlerën e drejtë ( vlerën reale ) për shkak të mosnjohjes së vlerës fillestare, në mungesë të dokumentacionit në momentin e kalimit të ndërtësive në pronësi të Kuvendit.	Drejtes i Programit Buxhetor Administrativ; Shërbimi i Mirëmbajtjes	Sekretari i Përgjithshëm	PBA 2024-2026
4	2.1	Shërbimi Administrativ, shërbimi i Mirëmbajtjes në varësi të tij, të marrin masa paraprake për vënien në dispozicion të hartave dhe të tjera të nevojshme për procesin e vlerësimit të pasurive të paluajtshme	Shërbimi i Mirëmbajtjes	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Administrativ	Janar-Prill 2023
5	2.2	Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, të lëshohen urdhrat përkatës, për kontabilizimin e vlerës së drejtë të ndërtësive dhe trojeve në pronësi të Kuvendit, me qëllim pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive kontabël	Shërbimi i Financës	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Administrativ	Pas realizimit të procesit të vlerësimit pasurive të paluajtshme
6	3.1	Të përpilohet dhe dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kërkesa për dhënen e autorizimit për fillimin e procedurave për shfjten nëpërmjet ankandit publik të pjesëve të këmbimit mall stock. ( ne zbatim te nenit 4 të ligjit nr.9874 datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”)	Shërbimi i Transportit	Sekretari i Përgjithshëm	Nëntor-Dhjetor 2022
7	4.1	Analizë e detyrimeve të prapambetura gjendje 31.12.2021	Shërbimi i Financës dhe Buxheit	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Administrativ Sekretari i Përgjithshëm	Nëntor 2022
8	4.1	Të ridërgohen shkresa zyrtare tek debitorët që rezultojnë të mbledhsëm	Shërbimi i Financës dhe Buxheit	Sekretari i Përgjithshëm	Dhjetor 2022
9	4.1	Shërbimi Juridik të bëjë argumentimin ligjor të detyrimeve që rezultojnë të pambledhsme dhe mund të parashkruhen, për ti paraqitur në Byronë e Kuvendit	Shërbimi Juridik dhe Shërbimi Financës dhe Buxheit	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Administrativ	Nëntor 2022
10	4.1	Informimi i Byrosë së Kuvendit dhe marrja e vendimit për parashkrimin dhe kalimin në humbje të debitorëve të viteve 2000-2002	Shërbimi i Financës dhe Buxheit	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Administrativ	Dhjetor 2022

		Ngritja e grupit të punës me përfaqësues të Shërbimit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Koordinatorin e deleguar të kontrollit të brendshëm (KDKB) për hartimin e Gjurmëve të auditimit për regjistrimin, ndjekjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë	Shërbimi Juridik Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputeteve	Drejtori i Përgjithshëm Shërbimit Legjislativ	Janar- mars 2023
11	4.2	Institucioni Kuvendit të organizojë çdo vit kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë së institucionit ( Kryesi, Salla Seanceve, Biblioteka dhe Zyrat zgjedhore) duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për diferencat.	Shërbimi Administrativ Shërbimi Financës	Sekretari i Përgjithshëm	Cdo vit
12	5.1	Të merren masa për rishikimin dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi "Për bibliotekat" të Rregullores së bibliotekës së Kuvendit	Drejtori i Përgjithshëm i Institutit Parlamentar Drejtor i Botimeve dhe Bibliotekës Parlamentare	Sekretari i Përgjithshëm	Mars 2023
13	5.2	Të informohet Byroja e Kuvendit për procesin e inventarizimit dhe diferencat e përgjegjësitë	Relacion Grupi i punës për inventarizim i ngritur me urdher të SP	Sekretari i Përgjithshëm	Pas kryerjes së procesit inventarizimit
14	5.1	Të merren masa për hartimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për vitin 2023-2025 dhe miratimin në Byro të saj.	Ekipi Menaxhimit të Riskut Koordinatori i Menaxhimit të Riskut	Sekretari i Përgjithshëm, Koordinatori i Menaxhimit të Riskut	Shkurt -Prill 2023
15	6.1	Të gjithë drejtorët e shërbimeve të Kuvendit duhet të rishikojnë regjistrin e riskut për shërbimin përkatës, dy herë në vit	Koordinatori i Menaxhimit të Riskut	Sekretari i Përgjithshëm	Janar dhe korrik të çdo viti
16	6.2	Të merren masa nga ana e KDMR (koordinatorit të deleguar të menaxhimit të riskut) për organizimin e punës për rishikimin e regjistrit vjetor institucional të riskut jo më pak se dy herë në vit	KDMR; Ekipi Menaxhimit të Riskut	Sekretari i Përgjithshëm, KMR(Koordinatori i Menaxhimit të Riskut) Byroja e Kuvendit	Janar dhe korrik të çdo viti
17	6.2	Të merren masa për të kërkuar në Byronë e Kuvendit, miratimin për ristrukturimin dhe riorganizimin e Njesisë së Auditit të brendshëm në Kuvend	Burimet Njerëzore dhe Trajtimi i Deputeteve	Sekretari i Përgjithshëm	Viti 2023
18	7.1	Të rishikohet Karta e Auditimit	Struktura e AB	Sekretari i Përgjithshëm	Pas realizimit të pikës 18 të këtij plani